

KËRKESË
Nr. 2690/2, datë 3.4.2012
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit: tokë bujqësore, tokë truall, ndërtim, shtëpi banimi dhe “kulturave bujqësore” që preken nga “Ndërtimi i hidrocentralit në lumin Devoll”.

Subjekti kërkuar i këtij shpronësimi është shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a. Me anën e këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

Brenda 15 ditëve pas publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore, kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës pranë komisionit të posaçëm të shpronësimit.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço